REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.

DHKPGJP
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 21625 Prot.
Datë 22.8.2022

SHOQËRIA PËRMBARIMORE SPAHIU

Nr. 409, Regj., Nr. 2293/1 Prot. Tiranë, më 18/08/2022

# URDHËR
## PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

**Drejtuar :** Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

**Për dijeni:** Debitorit, Subjektit "VM Resort" sh.p.k., me NIPT L82608801A
Adresa: Bulevardi i Pishave, Kompleksi Turistik "Murrizi", Golem, Kavajë

Kreditorit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr.56, Tiranë

**Objekti:** Likujdim Gjobe

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k. me NIPT: L62204027C, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2412, datë 17.12.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 409, kërkesën e kreditorit Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Tiranë, ndaj subjektit "VM Resort" sh.p.k. në lidhje me Titullin Ekzekutiv Akti Administrativ "Vendim Gjobe" Nr.1817/2, datë 30.08.2021.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit vullnetar të detyrimit, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2147/2 Prot, datë 28.02.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit

**KONSTATOVA se :**

Debitori, subjekti "VM Resort" sh.p.k., është vënë më dijeni për njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit subjektit "VM Resort" sh.p.k. në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe 53 të Ligjit Nr.26/2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

**URDHËROJ**

**Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:**

**Debitori, Subjekti "VM Resort" sh.p.k., me NIPT L82608801A**
Adresa: Bulevardi i Pishave, Kompleksi Turistik "Murrizi", Golem, Kavajë

**1.** Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me proceduren e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:
a. Adresen e ushtrimit të aktivitetit privat.
b. Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence.
c. Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit.

**2.** Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

**3.** Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

**4.** Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.**

Përmbarues GJYQËSOR

**Eqerem SPAHIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - EQEREM G.SPAHIU - PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT -

*Adresa: Rruga Ded Gjo Luli", Pall.1, Shk.2., Kt.2., Ap.21., Tiranë, e-mail: info@spahiu.al, mob.+355682039585*